

KËRKIME GJUHËSORE

Evalda PACI

TEKSTET E VJETRA SHQIPE NË KONTEKSTIN E NJË ANTOLOGJIE TË HISTORISË SË LETËRSISË SHQIPTARE

*Prova e qartë e qenies të një literature shqiptare të motshme, përmbledhja e këtyre teksteve dhe studimi i tyre prej nxanësve të klasave të nalta të shkollave të mesme, bajnë të mundshëm jo vetëm studimin e thellë të gjuhës s'onë, por dhe ushqejnë dashtënin për gjuhën amtare dhe na shtojnë me qenë madhështorë për të, si fëmija për bujarin qindvjetare të fisit të vet.*¹

Tiranë, Gusht 1936;
Ministr' i Arsimit
Dr. Nush Bushati.

Studimi i teksteve të vjetra shqipe bëhet objekt studimi i një disipline të veçantë siç është filologjia e teksteve shqipe.

Duke qenë njoftues të tipareve të një periudhe të rëndësishme të historisë së gjuhës së shkruar shqipe dhe të dokumentimit shkrimor të saj, si dhe për përmbajtjen që kanë në vetvete, mendojmë se introdukojnë më së miri dhe një vepër antologjike mbi autorë dhe tekste të letërsisë së shkruar shqipe.

Duke u projektuar si pjesë e një vepre që synon të jetë unike dhe të pasqyrojë një prurje të konsiderueshme të arritjeve në fushë të historisë së letërsisë shqiptare, përzgjedhja e tyre kushtëzohet nga një sërë faktorësh dhe vetë vendosja e tyre në përbërje të një vepre të përmasave të tilla kërkon dhe introduktimin e secilit me hyrje shpjeguese koncize dhe sintetike. Një fakt i tillë sigurisht nuk përjashton një hyrje të domosdoshme *ad hoc* mbi letërsinë e vjetër shqipe, bashkë me interpretimet e duhura mbi konceptimin e saj nga tradita e studimeve dhe lidhjet e natyrshme me historishkrimin e shqipes.

Duke marrë si shembull autorët më të hershëm të njohur që kanë shkruar në gjuhën tonë: Buzukun, Budin, Bardhin, Bogdanin, Matrangën etj., bie në sy fakti që në një periudhë kohore që shkon nga viti 1555 deri në botimin e Doktrinės së Kazazit janë shkruar e kanë arritur në ditët tona një sërë tekstesh që synojnë të jenë shqipërime librash me një destinacion të shpjegueshëm për kohën kur janë botuar dhe për kontekstin historik në të cilin nevojitej dhe realizimi i botimeve të tilla në gjuhën amtare, i kombinuar ndonjëherë me elemente tekstologjike që duheshin ruajtur në latinishten kishtarë.

Mendojmë se një traditë ekzistuese studimesh dhe botimesh fragmentare të teksteve në fjalë do të ndihmonte një studim të tillë, qoftë dhe duke pasur parasysh faktin që në disa raste një punë e tillë është konkretizuar dhe me

¹ Nga parathënia e veprës *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe* të E. Çabejt, Tiranë, 1936, f. I.

pranëvënie pjesësh që orientonin në drejtim të gjurmimit të tipareve të përbashkëta të ndërtimit të tekstit apo mjeteve shprehëse.²

Tekstet e vjetra shqipe janë studiuar e përshtatur dhe për shkollat tona që në gjysmën e parë të shekullit të kaluar, falë kontributit të Justin Rrotës, Eqrem Çabejt, Filip Fishtës etj. Të njëjtat tekste kanë shërbyer gjithashtu dhe si udhërrëfyes në drejtim të studimit të mëvonë të tyre në nivel universitar dhe pasuniversitar.

Në veprën e mirënjohur *Elemente të literaturës e të gjuhësisë shqipe (Tiranë, 1936)*³ Eqrem Çabej bën objekt studimi Buzukun, Matrangën, Budin, Bardhin, Bogdanin, për të vijuar me të tjerë autorë të mëvonë arvanitas. Sado të shkurtra të jenë pjesët e zgjedhura nga autorët e sipërpërmendur, jemi të mendimit se zgjedhja nga ana e studiuesit tonë nuk ka qenë e rastësishme por ka pasur si qëllim dhe përfaqësimin në këtë vëllim të tij të fragmenteve më domethënëse dhe përfaqësuese të krijimtarisë së secilit. Nga Buzuku përzgjidhet një pjesë nga kolofoni, emërtuar në këtë rasë nga Çabej si *Parathënie*, nga Matranga pjesë nga *Canzona spirituale* dhe nga lutja *Ati inë*, e pranishme dhe te Budi. Nga Frang Bardhi përzgjidhet një tekst hyrës i veprës bashkë me një grup proverbash, ndërsa nga Bogdani një fragment nga *Të Primitë para Letërarit* (emërtuar dhe në këtë rast si parathënie nga Çabej) bashkë me një tjetër nga *Plechienia e Sctepisse Bogdanagnet (Antichità della casa Bogdana)*, bashkë me variantin gjegjës të shkruar në italisht.

Çdo pjesë e zgjedhur qëndron më së miri në përbërje të veprës së cituar, duke qenë se nuk mungojnë shënime të vlefshme të natyrës gjuhësore dhe filologjike që në fakt do të karakterizojnë dhe më vonë metodologjinë e punës së Çabejt me tekstet shqipe, madje dhe në punime të përmasave më të konsiderueshme që kanë mbetur monumentale për historinë e filologjisë shqiptare.⁴ Pranëvënia (nuk besojmë e rastësishme) e teksteve të përbashkëta nga Matranga dhe Budi i shërben më së miri një qasjeje tekstologjike sidomos në rastin e një lutjeje themelore për liturgjinë siç është *Ati ynë*. Një qasje më tej e kësaj pune të Çabejt me atë të Justin Rrotës pikërisht në këtë pikëpamje, të gjetjes dhe vënies në përqasje tekste të ngjashme bën të mendojmë për një orientim të përbashkët në drejtim të një studimi skrupuloz të teksteve të vjetra nga ana e

² Një prirje e tillë vihet re dhe në shkrimin e Pal Skiroit në Gazetën *Tomori*, 1910, n. 10, f. 3, që ka si objekt studimi qasjen e një pjese nga libri i Buzuku me të njëjtin tekst gjegjës bibliik në gjuhën e arëbërëshëve të Sicilisë së asaj kohe.

³ Gjatë përgatitjes së kësaj kumtese kemi shfrytëzuar botimin anastatik të këtij vëllimi, realizuar nga botimet Çabej, Tiranë, 2009.

⁴ *Meshari i Gjon Buzikut, I, II, Hyrje, transliterim dhe transkribim*, botim kritik përgatitur nga E. Çabej, Tiranë, 1968. Përgatitjen e këtij botimi Eqrem Çabej e lajmëron që në vitin 1959, në një artikull të shkruar në Buletin të Shkencave Shoqërore, Tiranë, ndërsa trajton problematikën aktuale të interpretimit tekstologjik-filologjik të teksteve të vjetra shqipe dhe domosdoshmërinë e botimit të njëpasnjëshëm të tyre, gjithnjë në shërbim të konsolidimit të një tradite të shëndoshë të studimeve dhe botimeve filologjike të veprave të shkruara në gjuhën tonë.

TEKSTET E VJETRA SHQIPE NË KONTEKSTIN E NJË ANTOLOGJIE TË HISTORISË SË LETËRSISË SHQIPTARE

këtyre themeluesve të studimeve të filologjisë shqiptare. Pranëvënie të tilla kombinohen në një mënyrë ose në një tjetër pikërisht duke pasur parasysh se autorët në mënyrë të pashmangshme kanë bërë objekt të punës së tyre tekste themelore të liturgjisë, qoftë nga Bibla, qoftë nga praktika e Ritualeve të rritit roman.⁵

Të tilla tekste nuk humbasin asnjëherë mesazhin edukativ ndaj brezave që duhen formuar me një ndjesi të natyrshme ndaj gjuhës amtare dhe letërsisë së vjetër. Ato përçojnë në të njëjtën kohë dhe veçori të rëndësishme tipike për periudhën në të cilën janë shkruar dhe jo vetëm gjuhësore. Formimi përkatës i autorëve të kësaj letërsie bashkë me motivimin që të realizonin diçka të shkruar në gjuhën amtare nga ana tjetër mbetet diçka për t' u vënë në dukje ndërkohë që shpjegohen a citohen të tilla tekste.

Në lidhje me receptimin e një vepre që do të përmbajë tekste nga autorë përfaqësues të periudhave më të rëndësishme të letërsisë shqipe natyrisht që roli i mësimdhënësit është mjaft i rëndësishëm. Për tekste të cilat mendohet dhe të shoqërohen me nota të natyrës filologjike pa dyshim që një rol i tillë ndikon drejtpërdrejt në transmetimin dhe receptimin e njohurive tek nxënësit që do ta përdorin një vëllim të tillë.

Shfrytëzimi i botimeve filologjike që disponohen nga tradita e studimeve tona vjen në ndihmë të përzgjedhjes së teksteve që duhen integruar në këtë vëllim. Ato përbëjnë arritje dhe kontribute të rëndësishme në fushë të filologjisë shqiptare.⁶

Një problem mjaft i rëndësishëm i lidhur me përzgjedhjen e teksteve të vjetra shqipe është dhe ai i respektimit të një gjatësie të caktuar të tekstit në përbërje të një vëllimi të tillë që duhet të përmbajë tekstet më të mira të letërsisë shqipe.

Për secilin autor problematika paraqitet e ndryshme: te Buzuku pjesët nuk mungojnë në pikëpamje materiale, por paraqesin specifika të ndryshme dhe më të ngurtësuara në kuptimin që janë pjesë përbërëse e librave të ndryshëm (fakt i ditur tashmë) dhe vetë sjellja e tyre në këtë libër kushtëzohet nga një sërë faktorësh: fakti që pjesa e parë e librit është acefale, e cunguar në faqet e para përkatëse; fakti që një pjesë e himneve mjaft të rëndësishme për liturgjinë e orëve

⁵ Kemi parasysh dhe tekste të ngjashme nga Matranga dhe Buzuku, himne të caktuara si në rastin e *Të falemë Perendeshë* me *Salve Regina* të Buzukut, variantin e tekstit *Tetë të lumetë* të Matranga, gjendur dhe te Buzuku në *Mesharin* etj. Në rastin e punimit të cituar nga E. Çabej (1936) duhet vënë në dukje se edhe kriteri i gjatësisë së tekstit të analizuar synohet të ruhet gjatë gjithë ecures së trajtesave të përmbajtura në libër, fakt që dëshmon dhe për aftësinë e studiuesit tonë për t'iu përshtatur parametrave të kërkuar nga një libër i destinuar për nxënësit e shkollave të mesme dhe mësimdhënësit e tyre.

⁶ Kemi parasysh këtu jo vetëm ribotimet e njohura të *Mesharit* të vitit 1958 dhe 1968, por dhe botime të fundit mbi veprat e letërsisë së vjetër shqipe, të realizuara pothuaj gjysmë shekulli më vonë nga Bardhyl Demiraj, Anila Omari, të cilat plotësojnë më së miri një panoramë të ribotimeve të këtyre veprave në kohët tona.

por dhe për poeticitetin përkatës të dukshëm përmbajnë një numër të konsiderueshëm fjalësh të huaja si rezultat i mungesës së përpunimit deri atëherë në traditën e përdorimit të këtyre teksteve nga përdoruesit (besimtarët dhe famullitarët); fakti që një pjesë e teksteve, veçanërisht atyre biblike paraqiten të papërfunduara në pikëpamje të mesazhit që duhet përcjellë; fakti që në disa pjesë me përmbajtje të dukshme poetike nga *Besëlidhja e Vjetër* gjurmohen ekuivoke të qarta në drejtim të ndonjë përdorimi rasor apo të ndonjë elementi predikativ të rëndësishëm. Një tekst mjaft i përshtatshëm është ai i *kolofonit*, tekstit përmbyllës të *Mesharit*, meqë mbart vërtet elemente origjinaliteti në kuptimin e të shkruarit dhe përmbajtjes, duke pasur gjithsesi në përbërje të vet dhe elemente tekstore të pjesëve të trajtuara më parë të pranishme në fragmente biblike apo Epistulat e Apostujve. Po aq i domosdoshëm do të kishte qenë dhe ndonjë fragment introduktiv i veprës, që nuk disponohet për arsye thellësisht objektive, pikërisht për mungesën fizike të faqeve të para të librit, problem ekzistues që në zbulimin e parë të këtij libri në vitin 1740.

Një specifikë të veçantë e një problematikë jo më pak të ndërlikuar paraqesin tekstet e Pjetër Budit, të pranishme gjithashtu në vëllimet e sipërpërmendura dhe në studimet mbi letërsinë e vjetër shqipe, përfshirë dhe botime të pjesshme të realizuara paralelisht me ato të Buzukut⁷.

Nga gjurmimi i këtyre pjesëve nga krijimtaria dhe veprimtaria shqipëruese e këtij shkrimtari vërehet fare lehtë se tekstet me të cilat ai introdukton veprat e tij janë të përmasave të ndryshme nga ato të autorit paraardhës të sipërpërmendur. Në lidhje me këtë autor, pa dyshim duhet të synohet në një kombinim sa më të goditur të zgjedhjes së teksteve, qoftë atyre poetike, qoftë atyre në prozë.⁸

Integrimi i teksteve nga vepra e Bardhit dhe ajo e Bogdanit paraqet gjithashtu të tjera specifika. Secila nga veprat që tradicionalisht trajtohen në kuadrin e një periudhe të njohur si periudha e letërsisë së vjetër shqipe ngërthen karakteristikë *sui generis* për arsye të ndryshme, të lidhura që në krye të herës dhe me vetë destinacionin e ngushtë të krijimit të vet: një Dicionar latinisht-shqip (*Dictionarium latino-epiroticum, Romæ, 1635*), që fare mirë do të gjente vend trajtimi dhe në një studim mbi historinë e inicimit të leksikografisë shqiptare, paraqet veçanti në disa drejtime dhe në këtë këndvështrim përzgjedhja duhet orientuar nga tekstet hyrëse të veprës dhe te e ashtuquajtura *Admonitio de erroribus* në përmbyllje të saj, që në vetvete ofron mjaft mundësi qasjeje me elemente të ngjashme në të tjera vepra të kësaj letërsie.

⁷ Shih gjithashtu dhe Revista *Leka*, variante të sjella nga D. Ndre Mjedja, Vjeti IV, shtatuer 1932, n. 9, f. 265-268; numri 10, Prei librit "Pasëqyra e të Rrfyemit" së Timzot Pjetër Budit, f. 304-308 etj.

⁸ Përmby një liber të panjoftun, Të rekomenduom e të poresitun Upeshkëpinjet e Vikarinjet e gjithë sá tjerë Prelatë gjinden ndë gjuhu tanë t'Arbëneshë, në Revista *Leka*, 1932, f. 224-229, prej D. N. Mjedjes.

TEKSTET E VJETRA SHQIPE NË KONTEKSTIN E NJË ANTOLOGJIE TË HISTORISË SË LETËRSISË SHQIPTARE

Një çështje më vete përbën vepra *Cuneus prophetarum* (1685) dhe fragmentet përkatëse nga Bogdani, një nga veprat më të arrira dhe më të shfrytëzueshme nga shumë pikëpamje. Duke qenë dhe në pikëpamje të përmasave më e konsiderueshme si vepër, duke përmbajtur një sërë trajtesash që dëshmojnë një përgatitje të rrallë pluridimensionale të autorit dhe një prirje gjithëpërfshirëse nga ana e tij e shumë argumenteve nga fushat themelore të dijes njerëzore, puna me këtë të fundit do të paraqitet më e ndryshme se në rastet e tjera.

Domosdoshmëria e integritetit të teksteve të tilla në përbërje të një punimi që synon të përfshijë arritjet më të mira të letërsisë shqipe dhe të bëhet një *vademecum* në përdorimin dhe konsultimin në perspektivë diakronike të kësaj letërsie, domosdoshmërisht do të kërkojë dhe evidentimin e atyre varianteve të disponueshme që ruhen përkatësisht në arkivin dhe bibliotekën e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë. Përmendim këtu një sërë studimesh mbi autorët e vjetër, kontribute që mbajnë emrin e Eqrem Çabejt, Osman Myderrizit, Mahir Domit, Henrik Lacajt etj., por dhe variante të hershme të këtyre veprave që do i shërbejnë patjetër dhe pasurimit grafik të veprës në fjalë.

Së fundi, do propozonim në këtë diskutim të shihej në perspektivë realizimi i një vepre që përmban kryesisht tekste të kësaj periudhe që tradicionalisht emërtohet si letërsi e vjetër shqipe, e cila kërkon pa dyshim dhe një tjetër përzgjedhje dhe një tjetër përfshirje të fragmenteve nga veprat e sipërcituara. Në këtë rasë, pranëvënja e mjaft teksteve të ngjashme nga autorë të caktuar do të merrte një tjetër konotacion, duke u bërë më domethënëse dhe në aspektin e trajtimit filologjik të tyre. Kemi parasysh kur gjenden dhe gjurmohen motive të ngjashme nga Buzuku e Bogdani, të dy autorë që dhe pse kanë ndërtuar vepra krejt të ndryshme mes tyre, mund të qasen pikërisht duke pasur parasysh episode si *Martesa e Kanës*, *Të ngjallunitë e Lazrit*, *Pasioni i Krishtit* etj.

Me mjaft interes paraqitet përkimi dhe diversiteti i njëkohshëm në drejtim të trajtimit të motiveve të caktuara si Gjeneza, Eksodi (me citimet përkatëse nga njëri dhe tjetri libër), që i përkasin Besëlidhjes së vjetër.⁹ Shkalla e përkimit dhe e mospërkimit ndryshon te Bogdani nga një pjesë e veprës në tjetrën, por shërben gjithsesi dhe për të nënvizuar më tej idenë e të qenit të ndryshme si vepra dhe si realizime për shumë arsye, ndër të cilat mbeten të rëndësishme periudha në të cilën janë shkruar, kushtet në të cilat janë realizuar konkretisht dhe formimi përkatës i secilit prej autorëve të marrë në shqyrtim.

Qasja e të njëjtëve autorë bëhet dhe në rang studimesh më specifike, që kanë të bëjnë me përvijimin progresiv të një terminologjie të liturgjisë, me çështje të evolucionit të trajtëformave të fjalëve të caktuara nga njëri autor në tjetrin, çështje të kalkimit apo shkallës së shqipërimit të sintagmave të caktuara etj. Janë një sërë problemesh dhe çështjesh sa teknike aq dhe konkrete e specifike sa herë flitet për secilin nga këta autorë të kësaj letërsie. Pajisja me shpjegime dhe

⁹ Bogdani P., *Cuneus prophetarum*, botim kritik përgatitur nga A. Omari, Tiranë, 2005, Shkall. III, Ligj. I, f. 90-95.

EVALDA PACI

interpretime të teksteve të zgjedhura natyrisht që do të kërkojë dhe një mbështetje me të dhëna dokumentare nga zhvillime paralele në fushë të historishkrimit dhe historisë së vendit tonë. Të tilla trajtesa me një optikë të qartë ndërdisiplinore ofron tradita e studimeve tona nën emrat e studiuesve të njohur si M. Roques, E. Çabej, I. Zamputi, M. Camaj, R. Ismajli, E. Sedaj etj.

Në përmbyllje të kësaj trajtese, duke rikujtuar se tekstet e vjetra shqipe përfaqësojnë një fillim dinjitoz dhe mjaft domethënës të traditës shkrimore të gjuhës sonë, duke e radhitur historinë e letërsisë sonë të shkruar krahas letërsive të tjera në Evropë, tradita e të cilave gjithashtu inicohet me sprovë të sjelljes në gjuhët përkatëse të shkrimeve të shenjta, ripohojmë një vend dinjitoz të tyrin në një punim të ardhshëm me objekt të gjerë studimi mbi historinë e letërsisë shqiptare.

BIBLIOGRAFI

- Bogdani P., *Cuneus prophetarum, botim kritik i përgatitur nga A. Omari*, Tiranë, 2005.
- Budi P., *Poezi (1618-1621), (botim kritik përg. nga R. Ismajli)*, Rilindja, Prishtinë, 1986.
- Budi P., *Poezi, (Parathënia, tejshkrimi dhe komentet: R. Ismajli)*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- Camaj M., *Il « Messale » di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shëjzat, Romë, 1960.
- Çabej E., *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në BUSHT, n. 2, 1959.
- Çabej E., *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, BUSHSHT, n.3, 1963.
- Çabej E., *Shqipja në kapërcyell-Epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, botime Çabej, Tiranë, 2006.
- Çabej E., *Studime shqiptare, Vepra të zgjedhura*, ASHAK, Prishtinë, 2008.
- Demiraj B., *Gjon Nikollë Kazazi dhe "doktrina" e tij*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- Demiraj B., *Dictionarium latino-epiroticum (Romæ, 1635), per R. D. Franciscum Blanchum*, Botime Françeskane, Shkodër, 2008.
- Elsie R., *Letërsia shqipe. Një histori e shkurtër*, Skanderbeg books, Tiranë, 2006.
- Fishta F., *Nder gjurmimet e veprimit "De propaganda fide" në Balkan*, në Hylli i dritës, n. 7-8, 1932.
- Fishta F., *Mario Roques për filologjinë, kërkimet arkivale dhe historike të vendit tonë*, në BUSHT, n. 3, Tiranë, 1962.
- Ismajli R., *Tekste të vjetra*, botime Dukagjini, 2000.
- Marquet O., *Pjetër Bogdani, letra dhe dokumente*, Shkodër, 1997.
- Marlekaj L., *Pietro Bogdani e l'Albania del suo tempo*, Liantonio editore, Palo del Colle, Bari, 1989.
- Matranga L., *E mbsuame e krështerë*, (a cura di M. Mandalà), Salvatore Sciascia editore, 2004.
- Paci E., *Letërsia e vjetër shqipe në kontekstin e historisë së letërsisë shqiptare*, në Hylli i dritës, n.2, 2011.

TEKSTET E VJETRA SHQIPE NË KONTEKSTIN E NJË ANTOLOGJIE TË
HISTORISË SË LETËRSISË SHQIPTARE

- Petrota G., *Popolo, lingua e letteratura Albanese*, Palermo, 1932.
- Ressuli N., *I più antichi testi albanesi*, në *Shpirti Shqiptar*, nr.3, 1955.
- Ressuli N., *Il "Messale di Giovanni Buzuku"*, (riproduzione e trascrizione), Biblioteca Apostolica Vaticana, Romë, 1958.
- Ressuli N., *Shkrimtarët shqiptarë, I, (nga Buzuku tek arbëreshët e Greqisë)*, Botime Pakti, Tiranë, 2007.
- Riza S., *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, botime Toena, Tiranë, 2002.
- Riza S., *Vepra 4*, Prishtinë, 2004.
- Riza S., *Vepra të zgjedhura*, Tiranë, 2009.
- Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Librairie orientaliste P. Geuthner, Paris, 1932.
- Roques M., *Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe e shkrime të tjera*, (perkthye nga frengishtja e pajisë me shenjime plotësuese nga W. Kamsi), Botime Françeskane, Shkodër, 2011.
- Rrota J., *Per historin e alfabetit shqyp dhe studime tjera gjuhesore*, Botime françeskane, Shkodër, 2005.
- Zamputi I., *Shënime mbi kohën dhe jetën e Pjetër Bogdanit*, në Buletin për Shkencat Shoqërore, 1954, n. 3.
- Zamputi I., *Disa fletë të historisë së Shqipërisë në periudhën 1506-1574*, në Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria shkencat shoqërore, 1960, n. 2.
- Zamputi I., *Qëmtime mbi Pjetër Bogdanin*, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, n. 2, 1963.
- Zamputi I., *Ricerche su Pjetër Bogdani*, në *"Rassegna di studi albanesi"*, Romë, 1964, n. 1.
- Zamputi I., *Shënime mbi rrethanat e vdekjes së Pjetër Budit*, Buletin i Universitetit shtetnor të Tiranës, Seria shkencat shoqërore, 1958, n. 2.